



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË**

Nr. 367 Prot.

Tiranë, më 21 / 07 / 2013

**Lënda :** Dërgohet rekomandim për marrjen e masave për eliminimin nga programet e studimeve që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë publike dhe private, të literaturës që paragjykon dhe diskriminon të drejtat e komunitetit LGBT .

**Drejtuar :** **Z. MYQEREM TAJAJ**  
**MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**TIRANË**

**I nderuar zoti Ministër !**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, ju parashtrojmë sa më poshtë vijon:

Ky rekomandim ndër të tjera vjen si rezultat i një çështje që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar gjatë vitit 2012, lidhur me një ankesë të paraqitur nga Ambasada PINK/LGBT Shqipëri me pretendimin se teksti universitar “Mjekësia Ligjore” e autorëve Sokrat Meksi dhe Bardhyl Çipi diskriminonte dhe paragjykonte hapur komunitetin LGBT në Shqipëri. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj anekese Komisioneri me vendimin nr.27 datë



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

4.12.2012 vendosi konstatimin e diskriminimit përmes përmbajtjes së tekstit “Mjekësia Ligjore” të autorëve të mësipërm, pasi ato diskriminonin individët për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke rekomanduar që autorët të modifikonin tekstin në ato pjesë që ishin identifikuar si diskriminuese dhe kur kjo gjë nuk do të ishte e mundur të bënin heqjen e këtij teksti nga tregu dhe nga bibliotekat e institucioneve. Autorët e tekstit në zbatim të këtij vendimi kanë marrë masa për rishikimin e tekstit dhe eliminimin e parashikimeve diskriminuese në ribotimin e tij, dhe njëkohësisht tërheqjen e atyre kopjeve që mund të ishin akoma në qarkullim.

Megjithatë duke patur parasysh faktin se teksti “Mjekësia Ligjore” me autorë Prof.Dr.Sokrat Meksi dhe Prof.Dr.Bardhyl Çipi, ka një kohë mjaft të gjatë që përdoret si tekst universitar në disa fakultete, ekziston rreziku që tekstet e vjetra të përdoren si literaturë si nga institucionet e arsimit të lartë publike ashtu edhe atij privat.

Evidentimi i përmbajtjeve diskriminuese në tekstin e mësipërm erdhi si rezultat i çështjes të trajtuar nga Komisioneri, por ekziston potencialisht mundësia e ekzistencës së pranisë së përmbajtjeve apo informacioneve të pabazuar, lidhur me përkatësinë gjinore apo orientimin seksual të personave.

Ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës jo vetëm që të eliminojë parashikimet diskriminuese ekzistuese në programet mësimore të të gjitha niveleve, por edhe të përfshijë në to informacion për ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të koncepteve dhe veprimeve kundër modeleve të sjelljes diskriminuese. Bazuar edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis dy institucioneve tona, një nga angazhimet është pikërisht bashkëpunimi në drejtim të eliminimit të parashikimeve diskriminuese që mund të ekzistojnë në tekstet e ndryshme që përdoren në sistemin arsimor. Për gjithë sa më sipër:

## REKOMANDOJ:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të marrë të gjitha masat për të garantuar që të gjitha institucionet e arsimit të lartë private dhe publikë, gjatë procesit të miratimit të programeve dhe planeve mësimore, si dhe literaturës që do të përdoret, të mbajnë në



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

vëmendje ndryshimet në tekstin “Mjekësia Ligjore” e autorëve Prof.Dr.Sokrat Meksi dhe Prof.Dr.Bardhyl Çipi.

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të marrë të gjitha masat për të garantuar që të gjitha institucionet e arsimit të lartë private dhe publikë, gjatë procesit të miratimit të programeve dhe planeve mësimore, si dhe literaturës që do të përdoret, të evitojnë përfshirjen e teksteve dhe literaturës, që kanë në përmbajtjen e tyre parashikime dhe koncepte diskriminuese.
- Të silllet në kujtesë të drejtuesve të institucioneve arsimore publike dhe private, detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, jemi në pritje të përgjigjes për hapat që do të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)